

Në mbështetje të nenit 70. të Statutit të komunës së Preshevës /"Gaz. zyrtare e Komunës së Bujanocit ", nr. 12/2021/ dhe nenit 2 .të Vendimit mbi Këshillit komunal të komunës së Preshevës ("Fl.zyrt.e rrethit të Pcinjës "nr.31/08) , Këshilli komunal i komunës së Preshevës, në mbledhjen e vet të mbajtur më 28.12.2021 nxorri këtë:

## VENDIM

### I

Këshilli komunal i komunës së Preshevës nxjerr Vendim mbi rimbursimin e mjeteve të dedikuara nga Kosova për vërshimet e shkaktuara në fshatin Raincë dhe Rahovicë.

### II.

Mjetet e dedikuara nga Kosova do ti rimbursohen të dëmtuarve në bazë të Raportit të komisionit për vlerësimin e dëmeve nga fusha Amvisërisë, përfshirë nga fatkeqësitë elementare -vërshimet në muajin Maj të vitit 2021.

Rimbursimi i mjeteve të dedikuara do të bëhet në vlerën prej 40.000,00 din për secilin të dëmtuar .

### III.

Ndarja e mjeteve do të bëhet nga Buxheti i komunës së Preshevës pozicioni 48 , klasifikimi ekonomik 484- Burimi i financimit nr.05 "Donacionet nga vendet e jashtme".

### IV.

Obligohet Drejtorati për buxhet financa dhe prokurime publike që të ekzekutojë këtë Vendim .

### V.

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e miratimit .

Vendimit t'i dërgohet:Kryeshefit të Administratës komunale Preshevë ,drejtoratit për buxhet financa dhe prokurime publike , Këshillit komunal dhe Arkivit.

## Arsyetim

Këshilli Komunal i komunës së Preshevës ka sjellur Vendim mbi rimbursimin e mjeteve të dedikuara nga Kosova për vërshimet e shkaktuara në fshatin Raincë dhe Rahovicë.

Ndarja e mjeteve të dëmtuarëve gjegjësisht rimbursimi i mjeteve është bërë për shkak të vonesave dhe procedurave burokratike të shkaktuara nga Thesari.

## KËSHILLI KOMUNAL I KOMUNËS PRESHEVË

III .nr:400-112

Kryetare  
Ardita Sinani

